Banka e Shqipërisë
MATERIAL DISKUTIMI
2 (18)
2006

KURSI REAL EFEKTIV I KËMBIMIT NË SHQIPËRI KONCEPTET DHE MATJA E TIJ

ILIR VIKA

PËRMBAJTJA

1. Hyrje 6

2. Përkufizimi i kursit real të këmbimit 7

3. Matja e kursit real të këmbimit 10

3.1 Zgjedhja e indeksit të përafërt të çmimit 11
3.2 Zgjedhja e peshave 15
3.3 Lejimi i ndryshimit të peshave në kohë 18
3.4 Ndërtimi i kursit real efektiv 19

4. Sjellja e kursit real të këmbimit në Shqipëri 19

4.1 Metodologjia 20
4.2 Ecuria dhe krahasimet empirike 20

5. Vërejtjet përfundimtare 24

Referenca 26

Shtojca 1: Burimi dhe përshkrimi i të dhënave 28

Shtojca 2: Grafikët 4.a – 4.d 29

Shënime 31

ABSTRAKT

Kursi real efektiv i këmbimit (REER) është vlera e jashtme e monedhës së një vendi kundrejt monedhave të partnerëve të tij më të rëndësishëm, dhe është treguesi më i përdorur për matjen e konkurrencës në tregtinë ndërkombëtare. Qëllimi i këtij studimi është matja e kursit real dhe efektiv të këmbimit të monedhës shqiptare, lekut. Në fillim do të prezantojmë disa nga propozimet kryesore lidhur me përkufizimin e drejtë të kursit real të këmbimit. Pas diskutimit mbi avantazhet dhe disavantazhet që mbart secila mënyrë llogaritje e REER, do të mundohemi të ndërtojmë seritë e kursit real efektiv të këmbimit në Shqipëri, për të parë tendencën vlerësuese apo zhvlerësuese në terma realë të lekut dhe se sa i luhatshëm ka qenë ai.

1. HYRJE

Që me rënien e sistemit të Bretton Woods rreth tridhjetë vjet më parë, problemet që sjellin luhatjet në kursin e këmbimit janë kthyer në një nga temat më të nxehta të diskutimeve të politikëbërësve në ekonomitë e hapura, si në ato të zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim. Këto çështje kanë qenë prezente edhe në vendet e tranzicionit në Evropën Lindore, pasi volatiliteti i tepërt i kursit të këmbimit që me fillimin e procesit të liberalizimit, ka shkaktuar kosto të konsiderueshme në mirëqenien e këtyre vendeve. Në Shqipëri, gjithashtu, luhatjet e shpeshta të lekut gjatë vitit, me amplituda të mëdha sezonale kanë krijuar një mjedis kontingjent për eksportuesit dhe importuesit vendas.

Shqipëria është një vend me një ekonomi të vogël e të hapur, ndaj dhe kursi i këmbimit të lekut luan një rol të rëndësishëm në ndikimin e nivelit të çmimeve në Shqipëri dhe në bilancin e pagesave në vend. Gjithashtu, hapja e ekonomisë shqiptare gjithnjë e më shumë ndaj tregjeve të huaja, përbën një interes të veçantë lidhur me pozitën konkurruese të bizneseve shqiptare në tregtinë në vend dhe jashtë tij. Për këtë arsye, matje të ndryshme të kursit efektiv të këmbimit nënvizojnë aspekte të ndryshme të efekteve që kursi i këmbimit ka në ekonomi, ndaj shpesh është e nevojshme të merren parasysh disa matje për të patur një pasqyrë të përgjithshme. Nëse qëllimi është për të parë efektin e kursit mbi nivelin e çmimeve, atëherë matja më e mirë është ajo që ka lidhje më të fortë me inflacionin. Ndërsa, në qoftë se fokusi është mbi influencën e kursit të këmbimit në ekonominë reale, atëherë kursi i këmbimit duhet të shihet si një variabël që ndikon konkurrencën në tregtinë e jashtme, aktivitetin ekonomik, dhe qëndrueshmërinë e bilancit të pagesave në një periudhë afatmesme.

Qëllimi i këtij studimi është të propozojë një metodologji për të matur kursin real efektiv të këmbimit të lekut, ndryshimet e të cilit mendohet të ndikojnë në pozitën konkurruese të ekonomisë vendase me jashtë. Për të matur këtë, duhet të ndërtohet një indeks i kursit real efektiv të këmbimit (REER), i cili bazohet në një numër të caktuar të kurseve dypalëshe të këmbimit të lekut. Ky indeks mund të shihet si një "monedhë" e përbashkët, e ponderuar me

peshat e caktuara sipas influencës në tregtinë ndërkombëtare të secilës monedhë të partnerëve tregtarë të Shqipërisë. Për të matur konkurrencën me vendet e tjera, indeksi REER, merr parasysh gjithashtu ndryshimet e çmimeve brenda vendit, të krahasuara me ndryshimet e çmimeve në vendet partnere tregtare.

Seksioni 2 do të diskutojë shkurtimisht mbi përkufizimet e ndryshme të kursit real të këmbimit, për të parë se në cilat raste është më e përshtatshme të përdoret një përkufizim i caktuar. Seksioni 3 do të paraqesë shqetësimet kryesore që hasin analistët kur duan të ndërtojnë kursin real efektiv të këmbimit, cilat janë meritat dhe të metat e sistemeve të ndryshme të peshave dhe indekseve të çmimeve të përdorura për ndërtimin e indeksit REER. Problemi se cili nga indekset e çmimeve do të zgjidhet për matjen kursit real është po aq i rëndësishëm sa edhe zgjedhja e peshave që do të vendosen për çdo vend partner tregtar. Mesazhi kryesor i këtij seksioni është se përkufizimi dhe llogaritja më e përshtatshme e kursit real efektiv të këmbimit varet nga një bashkëveprim i ndërlikuar i modeleve teorike që i shërbejnë interesit tonë, si edhe nga disponueshmëria e të dhënave. Ndërsa në seksionin e katërt, do të hedhim vështrimin shkurtimisht mbi sjelljen aktuale të lëvizjeve të kursit real efektiv të lekut, për të përcaktuar prirjen e REER dhe se sa volatil ka qenë ai.

2. PËRKUFIZIMI I KURSIT REAL TË KËMBIMIT

Shpesh, modelimet e kursit të këmbimit fokusohen mbi kursin real të këmbimit, i cili llogaritet si kursi nominal (vlera e monedhave që ne shohim në zyrat e këmbimit), i korrektuar me normën e inflacionit brenda dhe jashtë vendit. Arsyeja kryesore pas kësaj është se për shkak të niveleve të ndryshme të inflacionit, kursi nominal i këmbimit nuk reflekton me saktësi fuqinë blerëse të monedhës vendase për mallra dhe shërbime të huaja. Nëse vlera e kursit e përcaktuar në treg nuk është konsistente me kursin e nënkuptuar nga një model ekonomik, atëherë ekonomistët do të parashikonin mundësinë e disa rregullimeve në treg.

Teoria e parë, më e hershme, e përdorur për të përcaktuar nëse një monedhë ishte e mbivlerësuar apo e nënvlerësuar, njihet si

Pariteti i Fuqisë Blerëse (PPP). Kjo teori, e cila daton që nga Shkolla Salamanka në Spanjën e shekullit të 16-të, është një version me shumë mallra i ligjit të një çmimi. Pariteti i Fuqisë Blerëse është një kusht që thotë se, nëse injorojmë kostot e transportit, ndryshimet e taksave dhe kufizimet e tregtisë, për shkak të arbitrazhit të mirat dhe shërbimet e tregtueshme duhet të kenë të njëjtin çmim në të dyja vendet, pasi t'i konvertojmë çmimet e tyre në një monedhë të përbashkët. Sipas PPP, kursi i këmbimit K është thjesht i barabartë me raportin e çmimeve të huaja Ç* ndaj atyre vendase Ç për një shportë të caktuar mallrash e shërbimesh:

$$K_{PPP} = Ç^*/Ç \qquad (1)$$

Nëse Ç do të përfaqësohej nga indeksi i çmimeve të konsumit apo të çmimeve të prodhuesit, vlera e K_{PPP} do të maste çmimin relativ të shportës së konsumit/prodhuesit të huaj ndaj asaj vendase. Nëse supozojmë se ligji i një çmimi qëndron për të gjitha të mirat (të cilat janë zëvendësues perfekt), dhe shportat e konsumit janë identike për të gjitha vendet, atëherë teoria PPP qëndron (përderisa nuk ka të mira e shërbime të patregtueshme, sipas këtij definicioni), dhe kursi real i këmbimit do të ishte konstant (i barabartë me 1) (Chinn, 2002, dhe Lafrance & Schembri, 2002).

Por, pavarësisht se teoria e PPP ka qenë e njohur për shekuj me rradhë, në dekadat e fundit kjo mënyrë matjeje ka qenë subjekt i shumë kritikave dhe diskutimeve si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ajo praktike (shih për shembull Levich, 1998; Dornbusch, 1988; Samuelson, 1964; dhe Rogoff, 1996).

Lafrance dhe Schembri (2002) rendisin disa arsye të cilat kundërshtojnë përdorueshmërinë e teorisë PPP si përcaktuese e kursit të këmbimit. Së pari, ekzistenca e të mirave dhe shërbimeve të patregtueshme pengon shitjen e njëkohshme në disa tregje (e quajtur ndryshe arbitrazh). Së dyti, prania e kostove të mëdha të tregtisë, si kostoja e transportit, taksat dhe tarifat, kostoja e informacionit, barriera të tjera jo-tarifa etj., rrisin koston e arbitrazhit. Së treti, përbërja e artikujve të mallrave dhe shërbimeve në shportën e çmimeve ka shumë të ngjarë të ndryshojë nga njëri vend në tjetrin, veçanërisht për çmimet e prodhuesit kur krahasohen me çmimet e

konsumit. Së fundi, kursi real i këmbimit nuk mund të jetë konstant, sepse nivelet e çmimeve zakonisht i rezistojnë rënies së tyre, ndërsa kursi i këmbimit ndikohet gjithashtu nga goditjet afatshkurtra dhe reale (në periudhat afatgjata) në tregjet e parasë dhe të kapitalit.

Për këto arsye, shumica e ekonomistëve sot mbështesin gjerësisht përkufizimin e kursit real të këmbimit, të matur si raporti i çmimit relativ të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme ndaj atyre të patregtueshme ($Ç_T/Ç_P$) (Edwards, 1989b). Përkufizimi i kursit real në këtë mënyrë na lejon të masim shkallën e konkurrencës së sektorit të mallrave të tregtueshëm në vend. Një rritje në raportin $Ç_T/Ç_P$, do të bënte që prodhimi i mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme të ishte me fitim relativisht më të lartë, duke shkaktuar zhvendosjen e burimeve nga sektori i të patregueshmeve në sektorin e të tregtueshmeve. Gjithashtu, ky përkufizim është një matës i mirë i shkallës së konkurrencës së sektorit të jashtëm të një ekonomie me jashtë. Një rënie apo vlerësim i kursit real të këmbimit, do të pasqyronte një rritje të kostos së prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme në vend. Ndryshe nga përkufizimi i PPP, kursi real i këmbimit k sipas këtij mendimi do të shprehej si:

$$k = KÇ_T^* / Ç_P \qquad (2)$$

ku K është kursi nominal i këmbimit i shprehur si lek për njësi të monedhës së huaj[1] (Edwards, 1989a).

Ekuacioni (2) supozon se peshat e të patregtueshmeve në indekset e çmimeve janë të njëjta brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, ai nënkupton se ekonomia vendase është e vogël në krahasim me partnerët e tjerë tregtarë, kështu që çmimi i të tregtueshmeve përcaktohet nga oferta e ekonomive të mëdha për të mira të tregtueshme. Si rrjedhim, është çmimi relativ i të patregtueshmeve ai që lëviz për të arritur bilancin e brendshëm, domethënë ekuilibrin ndërmjet kërkesës dhe ofertës për mallra të tregtueshëm e të patregtueshëm (Chinn, 2002).

Megjithatë, Engel (1995) vë në dukje se çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme nuk barazohen menjëherë, të paktën në periudhën afatshkurtër. Shpesh, lëvizjet e çmimeve relative të

të patregtueshmeve janë të vogla sa që nuk mund të shpjegojnë ndryshimet në kursin real të këmbimit. Në këtë rast, kursi real do të matej si çmimi relativ i të mirave dhe shërbimeve të tregtueshme:

$$k = KÇ_T^*/Ç_T \qquad (3)$$

Ky përkufizim quhet ndryshe konkurrenca e çmimeve dhe është më i përshtatshëm për të gjetur çmimin relativ që arrin bilancin e jashtëm të tregtisë (Chinn, 2002). Rënia e vlerës së monedhës vendase do të sillte rritjen e eksporteve me jashtë.

Të dy përkufizimet e kursit real sipas teorisë PPP dhe çmimit relativ të të patregtueshmeve ndryshojnë nga njëri-tjetri. Madje ata mund të lëvizin në drejtime të kundërta në varësi të ndryshimeve të çmimeve relative jashtë vendit. Sipas Edwards (1989a), nëse supozojmë se në ekuacionin (1) indekset e çmimeve janë mesataret gjeometrike të çmimeve të tregtueshme e të patregtueshme:

$$Ç = Ç_P^{\alpha} \cdot Ç_T^{1-\alpha}, \qquad Ç^* = Ç_P^{*\beta} \cdot Ç_T^{*(1-\beta)} \qquad (3)$$

dhe se, për një vend të vogël si Shqipëria, nocioni PPP mbetet për mallrat e tregtueshëm (domethënë $Ç_T = KÇ_T^*$), pastaj ne mund të gjejmë lidhjen ndërmjet ndryshimit në përqindje të kursit real *k* dhe k_{PPP}:

$$\overset{\circ}{k} = (1/\alpha)\, \overset{\circ}{k}_{PPP} + (\beta/\alpha)\left(\overset{\circ}{Ç}_T^* - \overset{\circ}{Ç}_P^*\right) \qquad (4)$$

ku shenja (°) përsipër tregon ndryshimin në përqindje.

3. MATJA E KURSIT REAL TË KËMBIMIT

Në seksionin e mëparshëm ne prezantuam shkurtimisht dy përkufizimet kryesore të kursit real të këmbimit, sipas teorisë PPP dhe çmimit relativ të të mirave të tregtueshme e të patregtueshme. Kurse lidhja në ekuacionin e fundit tregon se si të dy përkufizimet mund të çojnë në përfundime krejt të ndryshme, në varësi të lëvizjes

së çmimeve relative jashtë vendit ($Ç_T^*/Ç_P^*$). Atëherë, cili përkufizim i matjes së kursit real të këmbimit është më i përshtatshëm? Ekonomistët, veçanërisht ata në vendet e tranzicionit, kanë shumë pak opcione për të vendosur, kur duan të ndërtojnë seritë kohore të kursit real në praktikë. Zgjedhja midis njërit apo tjetrit përkufizim përbën një kompromis midis avantazheve dhe disavantazheve të secilës matje, në varësi të qëllimit të saj. Matja e kursit real sipas përkufizimit në ekuacionet (2) dhe (3) do të ishte ndoshta më e mirë, pasi ai kap më mirë ndryshimet në shkallën e konkurrencës. Megjithatë, në realitet, është tepër e vështirë që të bëhet një ndarje e saktë e mallrave në të tregtueshëm e të patregtueshëm, ndaj dhe të dhënat e këtyre treguesve për shumicën e vendeve janë të padisponueshme.

Për këtë arsye, shumica e agjencive që llogarisin kurset reale të këmbimit përdorin indekse të përafërta për çmimet e të tregtueshmeve dhe të patregtueshmeve, si indeksi i çmimeve të konsumit, indeksi i çmimeve të prodhuesit, çmimet e eksportit dhe importit, deflatori i PBB-së dhe indeksi i kostos së punës për njësi. Më poshtë, në nënseksionin 3.1 do të shpjegojmë në mënyrë të përmbledhur mbi meritat dhe të metat e secilës nga këto matje. Megjithatë, siç do të shohim, zgjedhja e indekseve të përafërta të çmimeve e afron shumë matjen e kursit real me përkufizimin e së Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP).

3.1 ZGJEDHJA E INDEKSIT TË PËRAFËRT TË ÇMIMIT

Për të zgjedhur treguesit që do të përdoren në ndërtimin e indeksit të kursit real të këmbimit, fillimisht duhet të vendoset se cilët mallra dhe shërbime na interesojnë. Nëse vëmendja është mbi çmimin relativ që arrit bilancin e jashtëm të tregtisë, atëherë indeksi i përafërt i çmimeve duhet të përfaqësojë një shportë të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme të cilat janë të krahasueshme midis vendeve. Kjo për faktin se është sektori i mallrave të tregtueshme që ndikohet direkt nga ndryshimet në kursin real të këmbimit. Në të kundërt, çmimet e të patregtueshmeve do të duhej të përfaqësoheshin nga një indeks i përafërt që do të përmbante më shumë të mira e shërbime të patregtueshme.

Në praktikë, megjithatë, ka vetëm disa indekse çmimesh të cilat mund të përdoren për matjen e kursit real të këmbimit: indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), indeksi i çmimeve të eksportit (IÇX), indeksi i çmimeve të prodhuesit (IÇP), deflatori i PBB-së, (DPBB) dhe indeksi i kostos së punës për njësi (ULC). Secili nga këta indekse ka avantazhet dhe disavantazhet e tij.

Megjithëse indeksi i çmimeve të konsumit është një matës më i mirë i fuqisë blerëse me jashtë se sa i konkurrencës ndërkombëtare, ai përdoret gjerësisht për llogaritjen e kursit real, pasi ai është më i lehtë për t'u gjetur për të gjitha vendet. Pavarësisht se IÇK përfshin një grup të gjerë të mirash e shërbimesh, ai është një përafrues i anshëm në llogaritjen e shkallës së konkurrencës së sektorit të mallrave të tregtueshëm, pasi në të përfshihen një numër i madh i mallrave të patregtueshëm. Çmimet e këtyre mallrave mund të divergojnë përgjatë kohësm, për shkak të rritjes së ndryshme të produktivitetit në këta sektorë. Kështu, indeksi i përgjithshëm i çmimeve mund të çojë në përfundime të pasakta të çmimeve të të mirave të tregtueshme. Nëse shumica e shërbimeve dhe banimi do të klasifikoheshin si të patregtueshme në shportën e konsumit, kurse artikujt e prodhuar dhe për përdorim të gjerë (përfshirë energjinë dhe lëndën djegëse) si të tregtueshme, atëherë peshat e tyre në IÇK në Shqipëri[2] do të llogariteshin 46.6 dhe 53.4 për qind, përkatësisht. Në qoftë se do të ishim të interesuar më shumë të masim bilancin e brendshëm, atëherë RER i bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit do të na jepte rezultate jo të sakta. Gjithashtu, pesha e madhe e çmimeve të mallrave të importuar në shportën e konsumit bën që kursi real i bazuar në IÇK, të nënvlerësojë përmirësimet e konkurrencës në rastin e zhvlerësimit të monedhës.

Deflatori i PBB-së, duke qenë edhe indeksi i çmimeve të prodhimit të brendshëm në ekonomi, mendohet se do të jepte një tregues të mirë të ndryshimeve të shkallës së konkurrencës për prodhimin e përgjithshëm. Megjithatë, Chinn (2002) argumenton se deflatori i PBB-së, ashtu si edhe IÇK, përmban në vetvete një peshë të konsiderueshme të të mirave e shërbimeve të patregtueshme, si ndërtimi dhe shpenzimet e qeverisë. Për më shumë, një disavantazh i madh i këtij deflatori është se për vendet në zhvillim, përfshirë

Shqipërinë, të dhënat e PBB-së bëhen të disponueshme vetëm në bazë vjetore[3].

Çmimet relative të eksporteve vendase dhe të konkurruesve të huaj janë matja më direkte e çmimeve të të mirave të tregtueshme. Megjithatë, lloji i artikujve të eksporteve shqiptare është i përqendruar vetëm në disa produkte dhe ndryshon jashtë mase nga shporta e produkteve të eksportuara nga partnerët kryesorë tregtarë si Greqia dhe Italia. Ndaj dhe këto të dhëna statistikore nuk mund të jenë shumë të vlefshme në rastin e Shqipërisë.

Në përgjithësi, indeksi i çmimeve të prodhuesit (IÇP) apo i çmimeve me shumicë (IÇSH) janë përafrues më superiorë se çmimet e konsumit, nëse duam të llogarisim çmimet relative të mallrave të tregtueshëm, pasi ato përmbajnë kryesisht të mira të tregtueshme (Chinn, 2002) dhe nuk ndikohen nga shtrembërimet e shkaktuara në nivelet me pakicë. Meqenëse ata përfshijnë të gjitha shitjet dhe jo vetëm eksportet, IÇP dhe IÇSH reflekojnë sjelljen e çmimeve të sektorit të të tregtueshmeve më mirë se çmimet e eksporteve. Gjithashtu, indekset e çmimeve të prodhuesit për prodhimin total ndikohen më pak nga çmimet e mallrave të patregtueshëm sesa indeksi i deflatorit të PBB-së, i cili përfshin artikuj të qeverisë si edhe të patregtueshme të tjera. Duke qenë se IÇP përmban më tepër artikuj industrialë (të cilët zakonisht klasifikohen si të "tregtueshëmx''), kursi real i bazuar në këto indekse do të ishte më pak i anshëm në matjen e konkurrencës me jashtë (Schoefisch, 1992). Por ekziston edhe ideja se këto indekse, veçanërisht indeksi IÇSH, përfshijnë shumë mallra të tregtueshëm homogjenë, të cilët, nëse shprehen në një monedhë të përbashkët, kanë prirje të jenë të barabartë (Officer, 1982). Kjo bën që kursi i këmbimit i deflatuar me indeksin e çmimeve me shumicë, të variojë shumë pak, kështu që matjet e ndryshimeve aktuale të shkallës së konkurrencës të jenë joreale.

Gjithashtu, nëse peshat e caktuara për çdo grupmall në shportën e secilit vend janë të ndryshme, atëherë përdorimi i IÇP do të ishte më pak i vlefshëm se IÇK (Chinn, 2002). Një rishikim i peshave në njërin apo të dyja vendet do të sillte përsëri ndryshime në kursin real të këmbimit edhe nëse inflacioni i këtyre mallrave është i

njëjtë. Chinn (2002) shton se kjo kritikë bëhet më e fortë nëse masim kursin real të këmbimit duke përdorur indekset e çmimeve të eksporteve.

Një tregues i rëndësishëm, i përdorur për të matur kursin real të këmbimit është indeksi i kostos së punës për njësi (ULC) në sektorin e prodhimit. Ky indeks mund të jetë një matës direkt i mirë i konkurrencës me vendet partnere tregtare, pasi ai tregon zhvillimet në koston e prodhimit në sektorët e rëndësishëm të ekspozuar ndaj konkurrencës me jashtë (Zanello dhe Desruelle (1997)). Në këtë kontekst, RER i bazuar në koston e punës për njësi – veçanërisht në sektorin e prodhimit, i cili përfaqëson më shumë të mirat e tregtueshme – do të ishte më superior si tregues i konkurrencës se indekset e çmimeve, pasi firmat mund të ulin çmimet e tyre sipas diktatit të kushteve ekonomike, në mënyrë që të ruajnë pjesën e tyre të tregut. Megjithatë, kursi real i bazuar mbi normën e pagave, teorikisht, është tepër i ndjeshëm ndaj ndryshimeve ciklike të produktivitetit (Edwards, 1989a). Përveç kësaj, të dhënat e kufizuara (dhe jo shumë të sigurta) mbi normën e pagave dhe llogaritjen e produktivitetit në Shqipëri e në disa vende të tjera të rajonit, përbëjnë një vështirësi të madhe për përdorimin e këtij indeksi. Në një nga raportet e FMN-së për Shqipërinë, Hollar (2003) është përpjekur të masë pozitën konkurruese të Shqipërisë duke dashur të ndërtojë një seri të RER të bazuar në ULC, por meqenëse të dhënat mbi indeksin e kostos së punës për njësi mungojnë, autori ka përdorur të dhëna të kufizuara të pagave (të shprehura në dollarë) për t'u përafruar me indeksin e ULC.

Sigurisht që asnjë prej këtyre indekseve nuk mund të jetë matës perfekt i kursit real. Zgjedhja e llogaritjes më të përshtatshme të kursit real të lekut varet nga një kompromis i modeleve teorike bazuar në qëllimin e matjes së kursit, si edhe nga disponueshmëria në kohë e të dhënave që nevojiten për llogaritjen e tij.

Seria më e përdorur në literaturë për deflatimin e kursit të këmbimit është indeksi i çmimeve të konsumit.[4] Nën supozimin se të gjitha të mirat e tregtueshme janë homogjene, dhe për rrjedhojë, çmimet e tyre barazohen në tregtinë ndërkombëtare, ky indeks mund të përdoret si tregues i zhvillimit relativ të çmimeve të

mallrave (dhe shërbimeve) të patregtueshëm në vend dhe jashtë tij.[5] Pavarësisht se ka arsye teorike për të preferuar llojet e tjera të indekseve të çmimeve kur duam të masim shkallën e konkurrencës, disa autorë kanë argumentuar se çmimet e konsumit mund të jenë të përshtatshme jo si përafrues të çmimeve të të mirave të tregtueshme, por si matës të kostos së prodhimit të tyre (Turner & Van't dack, 1993). Disa faktorë të prodhimit, sidomos puna dhe inpute të ndryshme (përfshi inputet e patregtueshme) në procesin e prodhimit përbëjnë deri-diku një faktor të rëndësishëm të çmimit final; megjithatë, kjo lidhje mund të jetë artificiale dhe vetëm për një periudhë afatshkurtër[6]. Një avantazh tjetër i rëndësishëm i IÇK-së është se seritë e këtij indeksi janë të disponueshme për çdo vend dhe publikohen zakonisht në frekuenca mujore.

Edwards (1989a) dhe autorë të tjerë propozojnë ndërtimin e kursit real të këmbimit duke përdorur indeksin e çmimeve të prodhimit dhe të çmimeve të konsumit si indekset më të përafërta për çmimet e mallrave të tregtueshëm e të patregtueshëm. Për rastin e një ekonomie të vogël e të hapur (supozojmë se PPP qëndron për të mirat e tregtueshme), ku çmimi relativ $Ç_T/Ç_P$ është faktori përcaktues i RER, përafrimi më i përshtatshëm do të ishte duke vendosur indeksin e huaj të çmimeve të prodhimit në numërues dhe indeksin vendas të çmimeve të konsumit në emërues (ekuacioni 2).

3.2 ZGJEDHJA E PESHAVE

Zgjedhja e peshave varet shumë nga qëllimi i llogaritjes së kursit real efektiv të këmbimit, i cili mund të matet për të parë efektin e kursit të këmbimit në konkurrencën me jashtë, në nivelin e inflacionit, në ekonominë reale, si dhe efektin e luhatjeve të kursit në vlerën e shprehur në monedhën vendase të borxhit të jashtëm apo të mbajtjes së aseteve të huaja. Në varësi të qëllimit, peshat e përdorura në ndërtimin e kursit real efektiv mund të bazohen në tregti, importe, eksporte (të cilat shpesh marrin parasysh edhe peshën e eksporteve të vendeve të treta), pjesën e ekonomisë së një vendi në PBB-në në botë, si dhe në llogarinë kapitale e financiare (Ellis, 2001). Nëse interesi jonë është të masim lëvizjet e kursit të këmbimit në çmimet e importit, pesha e importeve për secilin vend

të origjinës do të ishte më e përshtatshme. Kurse për matjen e efekteve që përcjellin ndryshimet e lëvizjes së kursit të këmbimit në ekonominë reale dhe në konkurrencën me jashtë, pesha e totalit të eksport-importeve për secilin shtet mund të ishte një bazë e arsyeshme krahasimi (Lafrance & St-Amant, 1999).

Llogaritja e peshave relative të importeve është e thjeshtë dhe matet nga raporti i importeve të secilit shtet ndaj totalit të importeve. Prandaj, vendet nga të cilat Shqipëria importon më shumë do të kenë edhe peshën me ndikimin më të madh në llogaritjen e kursit efektiv. Ndërsa llogaritja e peshave relative të eksporteve mund të përcaktohet ose nga pikëpamja dypalëshe, ose mund të marrë forma më të ndërlikuara nëse duam të kapim efektet e konkurrencës së eksporteve në tregjet e treta[7] (domethënë me eksportuesit e tjerë në tregun në fjalë).

Metoda dypalëshe është më e thjeshta dhe peshat llogariten në bazë të vëllimit të eksporteve të Shqipërisë me secilin prej partnerëve të saj. Një e metë e kësaj metode është se ajo nuk merr parasysh konkurrencën e dy vendeve në tregjet e treta dhe kështu, ajo mund të nënvlerësojë shkallën e konkurrencës që përballin firmat shqiptare në tregjet e huaja. Megjithatë, kjo mënyrë konsiderohet zakonisht si më e përshtatshme për ekonomitë në tranzicion si Shqipëria, ku zhvillimi i eksporteve është akoma në një fazë fillestare, me një diversifikim të ulët (si për llojin e produkteve të eksportuara ashtu edhe për shpërndarjen gjeografike të tyre) për të konkurruar me tregjet e treta. Gjithashtu, kjo metodologji përdoret edhe nga FMN për të llogaritur peshat e konkurrencës për 35 anëtarë "të rinj" të Fondit nga Evropa Lindore, përfshirë Shqipërinë, dhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik (Zanello & Desruelle, 1997). Në këtë mënyrë, peshat e konkurrencës të bazuara në flukset e tregtisë dypalëshe do të llogariteshin si:

$$W_{ij} = \frac{M_i}{M_i + X_i} m_j^i + \frac{X_i}{M_i + X_i} x_i^j \qquad (5)$$

ku M_i dhe X_i përfaqësojnë importet dhe eksportet e vendit i; m_j^i është pesha e importeve të vendit i me origjinë nga vendi j; dhe x_i^j është pesha e eksporteve të vendit i të shitura në vendin *j*.

Në parim, të gjitha vendet që ushtrojnë aktivitet tregtar me një shtet dhe zënë një peshë "të rëndësishme" në vëllimin tregtar duhet të përfshihen në shportën e kursit efektiv të këmbimit. Megjithatë, në praktikë, kufizimet në disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave mbi tregtinë e jashtme mund të detyrojnë përfshirjen e një numri më të ngushtë të partnerëve tregtarë në llogaritjen e kursit real efektiv. Gjithashtu, një shportë e përbërë nga shumë vende do të humbiste rëndësinë e saj (dhe do të ishte humbje kohe), nëse një shportë më e ngushtë e përbërë nga partnerët kryesorë tregtarë do të jepte rezultate të ngjashme.

Në rastin e Shqipërisë, dominimi i Italisë dhe Greqisë si partnerë kryesorë tregtarë (grafiku 3.1) sugjeron se numri i vendeve të tjera nuk përbën ndonjë ndryshim të madh në llogaritjen e kursit real efektiv të këmbimit të lekut. Ky fakt forcohet edhe më shumë nëse marrim parasysh periudhën pas prezantimit të monedhës së përbashkët evropiane, euro, e cila besohet të përdoret në shkallë të gjerë në marrëdhëniet tregtare në të gjithë Kontinentin Evropian.

Në zgjedhjen e vendeve të cilat do të përbëjnë shportën e kursit real efektiv të këmbimit, duhet patur parasysh gjithashtu se, nëse luhatjet e monedhave të tyre janë shumë të çrregullta, lëvizjet specifike të një monedhe të vetme mund të japin një paraqitje të gabuar për indeksin e përgjithshëm. Për shembull, zhvlerësimi i

Grafik 3.1. Peshat e importeve dhe eksporteve sipas shteteve në vitin 2002.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

thellë i monedhës indoneziane në vitet 1997-98 bëri që indeksi i kursit efektiv të dollarit australian të qëndronte në të njëjtat nivele, pavarësisht se ky i fundit ishte zhvlerësuar ndaj monedhave të tjera (Ellis, 2001, fq.10). Në të njëjtën mënyrë, me përfshirjen e Meksikës në llogaritjen e kursit efektiv të këmbimit, dollari amerikan u vlerësua me mbi 30 për qind ndërmjet fillimit të viteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990, ndërkohë që me përjashtimin e monedhës meksikane dollari amerikan u zhvlerësua disi në terma efektivë. Për këtë arsye, shumica e indekseve të kursit efektiv përmbajnë vetëm monedhat e atyre vendeve, të cilat gëzojnë norma të njëjta apo të moderuara të inflacionit (Turner & Van't dack, 1993).

3.3 LEJIMI I NDRYSHIMIT TË PESHAVE NË KOHË

Një çështje tjetër e rëndësishme në llogaritjen e peshave është edhe marrja në konsideratë e ndryshimit të peshave relative të tregtisë dypalëshe në periudha të ndryshme. Luhatjet në fluksin e import-eksporteve bëjnë që peshat korresponduese të vendeve partnere të ndryshojnë. Vlerësimi i lekut ndaj një monedhe të caktuar do të sillte, teorikisht, rritjen e importeve nga ai shtet. Si rrjedhim, edhe pesha korresponduese e këtij vendi ndaj totalit të importeve do të ndryshonte. Prandaj, nëse zhvillimet tregtare janë të vrullshme e të pabarabarta, ka të ngjarë që peshat fikse të japin një paraqitje të gabuar të ndikimit të lëvizjeve të kursit.

Ellis (2001) bën një bashkim të indeksit në mënyrë që të mund të lejohet ndryshimi i peshave në kohë. Sipas tij, indeksi më i mirë do të ishte duke përdorur metodën e Törnqvist. Por, duke qenë se ky indeks kërkon peshat e periudhës së ardhshme, metoda e Törnqvist është e pamundur për t'u llogaritur në një kohë të përshtatshme. Autori sugjeron llogaritjen e REER në kohën t si produkti i REER në periudhën përpara prezantimit të peshave të reja w(τ-B) me raportin e kurseve reale dypalëshe BRER për vendet i, të matura sipas mesatares gjeometrike në periudhën bazë B dhe korente t, duke përdorur peshat korente τ:

$$REER_t = REER_{\tau-B} \times \frac{\prod_i BRER_{i,t}^{w(i,\tau)}}{\prod_i BRER_{i,\tau-B}^{w(i,\tau)}} \quad \text{ku } t \geq \tau. \qquad (6)$$

3.4 NDËRTIMI I KURSIT REAL EFEKTIV

Pas përcaktimit të peshave të monedhave, kursi nominal efektiv i këmbimit NEER, i cili mat vlerën e monedhës vendase përkundrejt një shporte të monedhave të huaja, do të llogaritej sipas mesatares gjeometrike[8] të ponderuar:

$$NEER_t = \prod_{n=1}^{N} K_n^{W_n} \qquad (7)$$

ku K_n është kursi nominal i këmbimit për monedhën vendase dhe i vendit partner tregtar n.

Ndërsa kursi real efektiv i këmbimit REER do të llogaritej si mesatarja gjeometrike[9] e ponderuar e indeksit të çmimeve vendase krahasuar me çmimet në vendet partnere tregtare:

$$REER = \prod \left[\frac{Ç_h \cdot K_n}{Ç} \right]^{W_n} \qquad (8)$$

ku $Ç$ dhe $Ç_h$ janë indekset e çmimeve vendase dhe të huaja respektivisht, W_n është pesha korresponduese për vendin partner n, kurse K_n është përsëri kursi nominal i këmbimit për monedhën vendase dhe të huaj. Përsërisim se sipas kësaj vendosjeje, rënia e indeksit do të tregonte një vlerësim real, ndërsa rritja e tij nënkupton një zhvlerësim real të monedhës vendase.

4. SJELLJA E KURSIT REAL TË KËMBIMIT NË SHQIPËRI

Qëllimi i këtij seksioni është të shqyrtojë zhvillimet në indekset e ndryshme të kurseve reale të lekut, duke u përqendruar në drejtimet që ato kanë ndjekur dhe se sa të luhatshme kanë qenë ato. Një pikë tjetër që synohet të arrihet në këtë analizë është të shikohet gjithashtu, nëse ka me të vërtetë ndryshim, në qoftë se në ndërtimin e kurseve reale përdorim indekse të ndryshme të çmimeve.

4.1 METODOLOGJIA

Për të krahasuar sjelljen e REER janë ndërtuar dy indekse. Indeksi i parë, i cili për qëllim emërtimi është quajtur REER1, është ndërtuar duke përdorur indekset e çmimeve të konsumit (IÇK) si për vendet partnere ashtu edhe për Shqipërinë. Kurse indeksi i dytë, REER2, i cili ka për qëllim të shërbejë si një përafrim i matjes së raportit të çmimeve relative të mallrave të tregtueshëm ndaj atyre të patregtueshëm, përdor indekset e çmimeve të prodhuesit (IÇP) për vendet partnere si përafrues të çmimeve të tregtueshëm ($Ç_T$) dhe indeksin e çmimeve të patregtueshëm $Ç_P$ të zgjedhur nga shporta e konsumit IÇK në Shqipëri[10]. Të dyja indekset, REER1 dhe REER2, janë ndërtuar duke u bazuar në peshat tremujore të importeve dhe eksporteve (Ek. 5), dhe më pas është bërë një bashkim i indeksit që të mund të lejohet për ndryshimin e peshave në kohë (Ek. 6).

Në të njëjtën mënyrë, kurset reale dypalëshe BRER1 dhe BRER2 do të jenë analoget e indekseve të kursit real efektiv REER1 dhe REER2, ku BRER1 bazohet në çmimet e konsumit për të dyja vendet, kurse BRER2 është një matës i çmimeve relative të të tregtueshmeve ndaj të patregtueshmeve.

Gjithashtu, për të parë nëse ka me të vërtetë ndryshim apo jo numri i partnerëve tregtarë të zgjedhur për llogaritjen e kursit real efektiv, indeksi REER1 është llogaritur për dy shporta të ndryshme. E para është një shportë e ngushtë që përfshin katër partnerët kryesorë tregtarë (G4), të cilët janë Italia, Greqia, Gjermania dhe Turqia. Marrëdhëniet tregtare me G4 mbulojnë afërsisht tre-të-katërtat e tregtisë totale. Ndërsa shporta e dytë është më e gjerë dhe përfshin 16 shtete (G16), të cilat përbëjnë rreth 90 për qind të vëllimit tregtar. Grupi i 16-shes përfshin G4, Austri, Angli, Francë, Spanjë, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Slloveni, Zvicër, Kinë, Rusi dhe ShBA.

4.2 ECURIA DHE KRAHASIMET EMPIRIKE

Tabelat e mëposhtme dhe grafikët në shtojcën 2 tregojnë ecurinë midis indekseve REER1 dhe REER2 kundrejt kurseve reale

dypalëshe BRER1 dhe BRER2 me Italinë, Gjermaninë, Greqinë dhe ShBA për periudhën Janar1994 – Dhjetor 2003. Siç vërehet nga grafikët, indekset e kurseve reale të këmbimit tregojnë një shkallë luhatshmërie të madhe në të gjithë periudhën. Megjithatë, sipas treguesve të diferencës midis vlerës maksmimale dhe minimale të indekseve, vihet re një rënie e ndjeshme e këtyre luhatjeve gjatë viteve 2000-03 krahasuar me vitet 1994-97, ku lëvizjet e kursit të këmbimit të lekut dhe norma e inflacionit kanë qenë më të mëdha. Një krahasim i koeficientëve të variacionit për të dyja periudhat shfaq të njëjtat rezultate, me përjashtim të koeficientit të kursit real BRER1 me dollarin amerikan, i cili ka mbetur thuajse i pandryshuar. Ndërkohë që vitet 1994-97 dallohen nga rritje e zbritje të papritura të të gjitha indekseve dhe një prirje e paqartë e tyre me tendencë zhvlerësuese të lekut, periudha më pas karakterizohet nga një vlerësim i menjëhershëm i lekut në terma realë dhe nominalë – sidomos deri në fillim të vitit 2002 – ndaj të gjitha monedhave.

Tabelë 4.1: Treguesit kryesorë statistikorë të indekseve REER dhe BRER.

	BRER1 Lek/Dem	BRER1 Lek/Grd	BRER1 Lek/Itl	BRER1 Lek/Usd	REER1 (G4)	REER1 (G16)	REER2 (G4)	BRER2 Lek/Dem	BRER2 Lek/Grd	BRER2 Lek/Itl
	1994M1 : 1997M12						1994M4 : 1997M12			
Mes.	179.9	170.3	161.9	119.8	162.6	160.0	177.2	194.8	179.9	179.6
Dev.St.	12.3	11.4	12.1	10.7	11.2	10.9	15.4	13.9	15.5	17.0
K.V.	6.9	6.7	7.5	8.9	6.9	6.8	8.7	7.1	8.6	9.4
Maks.	201.6	206.2	195.5	149.9	196.2	194.5	226.4	232.8	228.3	231.6
Min.	146.8	152.5	140.7	105.6	145.4	143.8	151.8	165.9	151.8	154.3
	2000M1 : 2003M12						2000M1 : 2003M12			
Mes.	111.7	113.9	112.1	101.8	111.7	111.2	110.0	110.7	110.0	111.4
Dev.St.	4.8	5.0	4.7	9.2	4.6	4.3	5.2	5.2	5.2	5.5
K.V.	4.3	4.4	4.2	9.0	4.1	3.9	4.7	4.7	4.7	5.0
Maks.	119.5	121.2	117.8	114.8	117.8	116.8	123.8	124.6	124.0	125.9
Min.	99.0	100.0	99.6	76.6	99.2	99.2	97.9	97.7	98.7	98.7

Simbolet: 1=bazuar në IÇK; 2=bazuar në çmimet relative të të tregtueshmeve ndaj të patregtueshmeve.

Nga analiza e krahasimeve midis indekseve të kursit të këmbimit paraqiten këto rregullsi. Së pari, REER1 për shportën e ngushtë dhe kurset reale dypalëshe BRER1 kanë tendencë të lëvizin në të njëjtin drejtim në të gjithë periudhën, me përjashtim të vitit 1995 ku BRER1 i lekut me markën gjermane dhe dhrahminë greke, paraqesin luhatje disi më të çrregullta. E njëjta ecuri paraqitet edhe kur krahasojmë indeksin REER2 për G4 me kurset BRER2 të markës, dhrahmisë dhe liretës. Këto zhvillime provohen edhe nga treguesi i koeficientit të korrelacionit në tabelën 4.2, ku në të gjitha rastet ai i kalonte 0.98. Përjashtim bën rasti i korrelacionit më të vogël ndërmjet REER1(G4) dhe BRER1 *LEK/USD* me 0.73, i cili ka ardhur si rezultat i një korrelacioni të dobët e madje negativ prej –0.12 gjatë viteve 1999-2003. Volatiliteti më i madh i kursit real të dollarit amerikan krahasuar me nënfishat e tjera të euros (i matur sipas koeficientit të variacionit në tabelën 4.1) duket se mbështet rezultatet e korrelacionit të mësipërm dhe të dhënat e tregtisë së jashtme në bilancin e pagesave, nga ku vërehet se ekonomia shqiptare është e lidhur shumë me Zonën e Euros. Në një treg të lirë të këmbimeve valutore, volatiliteti i kursit të këmbimit mund të jetë një lloj treguesi i rëndësisë relative që kanë ekonomitë e vendeve partnere në tregti. Nëse luhatshmëria e euros ndaj lekut do të ishte më e ulët se volatiliteti i një monedhe tjetër, kjo mund të merret si një sinjal i marrëdhënieve të ngushta të Shqipërisë me Eurozonën (Thanati, 2004). Këto rezultate justifikojnë deri-diku edhe peshën e vogël të dollarit amerikan në llogaritjen e kursit real efektiv të bazuar në tregtinë e jashtme me Shtetet e Bashkuara.

Së dyti, nga paraqitja grafike e dy indekseve të kursit real efektiv sipas përkufizimeve alternative, vërehet se REER1 dhe REER2 për shportën e ngushtë me katër partnerët kryesorë lëvizin afër me njëri-tjetrin në të gjithë periudhën. Koeficienti i korrelacionit ndërmjet log(REER1) dhe log(REER2) për G4, gjatë periudhës 1994:01-2003:12 ishte 0.98. Këto gjetje sugjerojnë se për Shqipërinë, zgjedhja e indekseve të çmimeve të përdorura në llogaritjen e kursit real të këmbimit, nuk përbën ndonjë problem themelor. Këto rezultate, në fakt, ndeshen me përfundimet e studimit të Hollar (2003), ku vlerësimi i REER të bazuar në IÇK që prej fillimit të viteve 1990, është shumë më i theksuar se sa vlerësimi i REER sipas matjes së çmimeve relative, ndaj dhe ata ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri.

Tabelë 4.2. Matrica e korrelacioneve të logaritmeve (1994M1:2003M12).

	log(REER1-G4)	log($BRER2_{DEM}$)	log($BRER2_{GRD}$)	log($BRER2_{ITL}$)
log(REER2-G4)	0.98	0.987	0.999	0.998
log(REER1-G16)	0.999	--	--	--
log($BRER1_{DEM}$)	0.98	0.98	--	--
log($BRER1_{GRD}$)	0.995	--	0.98	--
log($BRER1_{ITL}$)	0.997	--	--	0.98
log($BRER1_{USD}$)	0.73	--	--	--

Simbolet: 1=bazuar në IÇK; 2=bazuar në çmimet relative
të të tregtueshmeve ndaj të patregtueshmeve.

Një tjetër rregullsi tregohet nga krahasimi i dy indekseve të REER1, të ndërtuara sipas shportës me 4 dhe 16 shtete. Të dyja seritë ndjekin shumë ngushtë njëra-tjetrën dhe korrelacioni i tyre prej 0.99 është një evidencë në rastin e Shqipërisë, përdorimi i një shporte më të gjerë për llogaritjen e REER1 nuk përbën ndonjë ndryshim të rëndësishëm nga një shportë më e vogël me katër partnerët kryesorë tregtarë. Kjo sugjeron se një numër relativisht i kufizuar i vendeve të përfshira në shportë është i mjaftueshëm për të kapur luhatshmëritë e kursit real efektiv të këmbimit të lekut.

5. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Ky studim paraqet disa nga çështjet që duhet të konsiderohen në llogaritjen e indekseve të kursit real dhe efektiv të këmbimit për analiza për qëllime të tjera ekonometrike. Siç u theksua, nuk ka një mënyrë matjeje të vetme të kursit real (apo edhe atij nominal), që mund të jetë e përkryer për të gjitha qëllimet. Literatura ofron disa mënyra të matjes nëpërmjet deflatorëve të ndryshëm të çmimeve, dhe gjithashtu ka disa zgjedhje të mundshme për përcaktimin e peshave dhe frekuencën e tyre, si dhe numrin e shteteve për t'u përfshirë në shportë. Zgjedhja më e përshtatshme varet nga qëllimi i punës.

Janë dy arsye kryesore që na shtyjnë të studiojmë kursin e këmbimit. E para ka të bëjë me efektin e ndryshimeve të tij (kursit) në nivelin e çmimeve në vend, ndërsa e dyta ka lidhje me influencën e kursit të këmbimit në ekonominë reale dhe bilancin e

pagesave, nëpërmjet ndryshimeve të çmimeve relative të mallrave e shërbimeve të tregtueshme e të patregtueshme. Ky studim mat kursin real dhe efektiv të këmbimit të lekut, i cili është një variabël që ndikon konkurrencën në tregtinë e jashtme, qëndrueshmërinë e bilancit të pagesave, si dhe tërë aktivitetin ekonomik. Pavarësisht nga numri i madh i treguesve të konkurrencës, kufizimi i të dhënave statistikore na detyron të masim indeksin e kursit real të këmbimit REER të bazuar në dy tregues: në indeksin e çmimeve të konsumit dhe në raportin e çmimeve relative të mallrave e shërbimeve të tregtueshme ndaj atyre të patregtueshme. Nga krahasimi i ecurisë së këtyre dy indekseve rezulton se prirjet e tyre janë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën dhe se në rastin e Shqipërisë, zgjedhja midis tyre nuk përbën ndonjë problem të rëndësishëm. Një fakt tjetër në llogaritjen e kursit real efektiv të lekut është se zgjedhja e numrit të shteteve partnere tregtare nuk përbën ndonjë ndryshim. Pozicioni dominues i Italisë dhe Greqisë në tregtinë e jashtme të Shqipërisë është i tillë, që matje të ndryshme të REER që ndryshojnë në bazë të numrit të vendeve partnere apo peshave të tyre në tregti, të lëvizin në një modë afërsisht të ngjashme. Të dy indekset e ndërtuar sipas shportës me 4 ose me 16 vende, shoqërojnë shumë ngushtë njeri-tjetrin në të gjithë periudhën e vrojtuar. Gjithashtu, lëvizjet në drejtime të njëjta të kursit real efektiv sipas përkufizimeve alternative dhe atyre dypalëshe analoge janë gjithashtu, një tregues i kënaqshëm që provon vlefshmërinë e rezultateve mbi ecurinë e shkallës së konkurrencës.

REFERENCA

Chinn, Menzie D., 2002, "The Measurement of Real Effective Exchange Rates: Survey and Applications to East Asia", University of California, Santa Cruz.

Çeliku, Evelina, 2003, "Kontributi i Inflacioneve të Mallrave të Tregtueshëm e të Patregtueshëm në Inflacionin Total: Rasti i Shqipërisë", Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi Nr. 1 (12)/03.

Dornbusch, R., 1998, "Purchasing Power Parity", New Palgrave: A Dictionary of Economics, NY: Stockton Press.

Edwards, Sebastian, 1989a, "Real Exchange Rates in the Developing Countries", NBER, wp2950.

———, ———, 1989b, "Real Exchange Rates in the Developing Countries: The Empirical Evidence", Real Exchange Rates, Devaluation, and Adjustment: Exchange Rate Policy in Developing Countries, MIT Press.

Ellis, Luci, 2001, "Measuring Real Exchange Rate: Pitfalls and Practicalities", Reserve Bank of Australia, Research Discussion Paper, 2001-04.

European Central Bank, 2003, "Review of International Role of Euro", December 2003.

Hargreaves, David & Bruce White, 1999, "Measures of New Zealand's Effective Exchange Rate", Reserve Bank of New Zealand: Bulletin Vol. 62 No. 3.

Hollar, Ivanna V., 2003, "Causes and Consequences of Real Exchange Rate Appreciation in Albania", IMF Country Report No.03/64 "Albania: Selected Issues and Statistical Appendix", March, pp. 4-22.

Kıpıcı, A. N. & M. Kesriyeli, 1997, "The Real Exchange Rate Definitions and Calculations", Research Department, Central Bank of Turkey, Publication No: 97/1, English Version.

Lafrance, R. & P. St-Amant, 1999, "Real Exchange Rate Indexes for the Canadian Dollar", Bank of Canada Review, Autumn.

Lafrance, R. & L. Schembri, 2002, "Purchasing-Power Parity: Definition, Measurement, and Interpretation", Bank of Canada Review, Autumn.

Levich, R.M., 1998, "International Financial Markets – Prices

and Policies, NY: McGraw Hill.

Officer, L., 1976, "The Productivity Bias in Purchasing Power Parity: An Econometric Investigation", IMF Staff Papers 23: 545–79.

Rae, D., 1994, "Exchange Rate and Inflation: are trade weights best?", National Bank of New Zealand.

Rogoff, K., 1996, "The Purchasing Power Parity Puzzle", Journal of Economic Literature 34 (2).

Samuelson, P., 1964, "Theoretical Notes on Trade Problems", Review of Economics and Statistics, 46, fq. 147-154.

Schoefisch, Ulf, 1992, "Measures of External and Internal Competitiveness", Reserve Bank of New Zealand: Bulletin, Vol. 55, No. 1, 1992.

Secretariat of the Committee on Economic and Monetary Affairs of the European Parliament, 2003, The role of the euro in the external trade of the acceding countries, notice to members, No. 23/2003, 18 November.

Thanati, Edmond, 2004, "Përbërja Optimale e Portofolit të Monedhave në Rezervën Valutore dhe Varësia e Tij ndaj Konceptit 'Risk Averse'", Banka e Shqipërisë, Draft jo i botuar.

Turner, Phillip & Jozef Van't dack, 1993, "Measuring International Price and Cost Competitiveness", BIS Economic Papers, No. 39, November.

White, Bruce, 1997, "The Trade Weighted Index Measure of the Effective Exchange Rate", Reserve Bank of New Zealand: Bulletin Vol. 60 No. 2, 1997

Zanello, Alessandro & Dominique Desruelle, 1997, "A Primer on the IMF's Information Notice System", IMF WP/97/71.

SHTOJCË 1: BURIMI DHE PËRSHKRIMI I TË DHËNAVE.

Shtetet	Të dhënat	Burimi
Austri	IÇK	Eurostat: HICP për Austrinë, 1996=100
	Kursi Lek/ATS	Banka e Shqipërisë; IFS (kursi Lek/ATS i llogaritur nga një cross rate i kursit ATS/USD)
Angli	IÇK	Zyra për Statistika Kombëtare, 1996=100
	Kursi Lek/GBP	Banka e Shqipërisë; IFS (kursi Lek/GBP i llogaritur nga një cross rate i kursit GBP/USD)
Francë	IÇK	Eurostat: HICP për Francën, 1996=100
	Kursi Lek/FRF	Banka e Shqipërisë; IFS (kursi Lek/FRF i llogaritur nga një cross rate i kursit FRF/USD)
Gjermani	IÇK	Zyra Statistikore Federale, GER, 2000=100
	IÇP	Statistikat Financiare Ndërkombëtare, 2000=100
	Kursi Lek/DEM	Banka e Shqipërisë
Greqi	IÇK	Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë, 1999=100
	IÇSh	Statistikat Financiare Ndërkombëtare, 2000=100
	Kursi Lek/GRD	Banka e Shqipërisë
Itali	IÇK	ISTAT, Itali
	IÇP	ISTAT, Itali, Çmimet e Prodhuesit
	Kursi Lek/ITL	Banka e Shqipërisë
Spanjë	IÇK	Eurostat: HICP për Spanjën, 1996=100
	Kursi Lek/ESP	IFS (kursi Lek/ESP i llogaritur nga një cross rate i kursit ESP/USD)
Bullgari	IÇK	Instituti Statistikor Kombëtar, 1995=100
	Kursi Lek/BRL	IFS (kursi Lek/BRL i llogaritur nga një cross rate i kursit BRL/USD)
Kroaci	IÇK	Banka Kombëtare Kroate, Vrojtimi Statistikor, tabela J1, 2001=100
	Kursi Lek/HRK	IFS (kursi Lek/HRK i llogaritur nga një cross rate i kursit HRK/USD)
Maqedoni	IÇK	Zyra Statistikore Shtetërore, dhjetor 1996=100
	Kursi Lek/MKD	IFS (kursi Lek/MKD i llogaritur nga një cross rate i kursit MKD/USD)
Slloveni	IÇK	Zyra Statistikore e Republikës së Sllovenisë, 1998=100
	Kursi Lek/	IFS (kursi Lek/SIT i llogaritur nga një cross rate i kursit SIT/USD)
Turqi	IÇK	Instituti i Statistikave Shtetërore pranë Kryeministrisë, 1994=100
	IÇP	Instituti i Statistikave Shtetërore pranë Kryeministrisë, WPI për Industrinë Prodhuese 1994=100
	Kursi Lek/TRL	IFS (kursi Lek/TRL i llogaritur nga një cross rate i kursit TRL/USD)
Zvicër	IÇK	Zyra Statistikore Federale Zvicerane, 2000=100
	Kursi Lek/CHF	Banka e Shqipërisë; IFS (kursi Lek/CHF i llogaritur nga një cross rate i kursit CHF/USD)
Kinë	IÇK	Banka Popullore e Kinës, 1993=100
	Kursi Lek/Yuan	IFS (kursi Lek/Yuan i llogaritur nga një cross rate i kursit Yuan/USD)
Rusi	IÇK	Instituti i Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), dhjetor 1999=100
	Kursi Lek/RUR	IFS (kursi Lek/RUR i llogaritur nga një cross rate i kursit RUR/USD)
ShBA	IÇK	Departamenti i Punës ShBA: Zyra Statistikore e Punës, 1982=100
	Kursi Lek/Usd	Banka e Shqipërisë
Shqipëri	IÇK	Faqja e internetit të Bankës së Shqipërisë
	Çmimi i të patregtueshëm	Çeliku (2003)
	Tregtia	Të dhënat mbi tregtinë e jashtme janë marrë nga faqja e internetit të Bankës së Shqipërisë

Shënim: BoA=Bank of Albania; Eurostat=Statistical Office of the European Communities; HICP=harmonised index of consumer prices; IÇK=indeksi i çmimeve të konsumit; IÇP=indeksi i çmimeve të prodhuesit; IÇSh (WPI)=indeksi i çmimeve me shumicë; IFS=IMF's International Financial Statistics.

SHTOJCA 2: GRAFIKËT 4.A – 4.D

Simbolet: 1=bazuar në IÇK; 2=bazuar në çmimet relative të të tregtueshmeve ndaj të patregtueshmeve.

Grafik 4.a: REER1 vs. REER2 për G4
(2002:02=100)



Grafik 4.b: REER1-G4 kundrejt REER1-G16
(Indeksi i kursit 2002:02=100)



Simbolet: 1=bazuar në IÇK; 2=bazuar në çmimet relative të të tregtueshmeve ndaj të patregtueshmeve.

Grafik 4.c: REER1(G4) vs. Kurseve reale dypalëshe BRER1 (2002:02=100)



Grafik 4.d: REER2-G4 vs. BRER2-itl, BRER2-grd, BRER2-dem (2002:02=100)



* Ilir Vika. Departamenti i Kërkimeve. Falenderoj në veçanti konsulentin tim Erjon Luçi. Falenderoj gjithashtu Evelina Çelikun dhe Manjola Tasen (Departamenti i Kërkimeve, BSH), si dhe Vladimir Klyuev (IMF Institute) për komentet dhe diskutimet e vlefshme. Mendimet e shprehura janë të autorit dhe nuk reflektojnë medoemos ato të Bankës së Shqipërisë.

[1] Sipas kësaj vendosje, rënia e indeksit do të tregonte vlerësimin e kursit real të këmbimit. Në të kundërt, nëse kursi nominal shprehet si numri i monedhës së huaj për njësi të monedhës vendase (metoda e adoptuar nga FMN), vlerësimi i kursit real do të shënohej si rritje e indeksit. Në këtë rast, formula do të ishte: $k = KÇ/Ç^*$ ose në formë logaritmike : $\ln(k) = \ln(K) + \ln(Ç) - \ln(Ç^*)$.

[2] Këto të dhëna janë llogaritur sipas peshave të përcaktuara nga INSTAT për çdo grupmall në shportën e konsumit.

[3] Treguesi i PBB-së në Shqipëri nxirret nga INSTAT një herë në vit, me një vonesë prej gati 6 muajsh.

[4] Në vend të indeksit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit, disa autoritete monetare përdorin indeksin e çmimeve bazë për të llogaritur kursin real. Kjo matje në përgjithësi lë jashtë çmimet e energjisë dhe ushqimeve, të cilat përcjellin luhatje të panevojshme në matjen e çmimeve relative.

[5] Gjithashtu, përfshirja e të mirave dhe shërbimeve të patregtueshme në IÇK e bën këtë indeks shumë të vlefshëm për të krahasuar konkurrencën midis vendeve për sa i përket ofertës së shërbimeve të turizmit.

[6] Turner & Van't dack, 1993, duke iu referuar Kahn, Mohsin, 1986, Comment (on "Economic Adjustment and the Real Exchange Rate" by Sebastian Edwards & Ahamed, 1986)

[7] Në varësi të natyrës së mallrave të tregtueshëm dhe llojit të tregut në të cilin ato tregtohen, në përgjithësi përdoren tre metoda të ndryshme të llogaritjes së peshave të tregtisë, të cilat bazohen në 1) flukest dypalëshe të tregtisë, 2) flukset e tregtisë ndërkombëtare, dhe 3) peshat e dyfishta për eksportet (për një përshkrim më të plotë të llogaritjeve shih Turner & Van't dack, 1993).

[8] Shumë studime kanë përdorur mesataren aritmetike për llogaritjen e kursit real efektiv, por ka arsye të forta teorike dhe statistikore për të preferuar mesataren gjeometrike, pasi kjo e fundit i trajton lëvizjet në kursin e këmbimit në mënyrë simetrike, duke i shmangur problemet që hasen nga përdorimi i mesatares aritmetike (për më shumë detaje, shih Ellis, 2001).

[9] Shumë studime kanë përdorur mesataren aritmetike për llogaritjen e kursit real efektiv, por ka arsye të forta teorike dhe statistikore për të preferuar mesataren gjeometrike, pasi kjo e fundit i trajton lëvizjet në kursin e këmbimit në mënyrë simetrike, duke i shmangur problemet që hasen nga përdorimi i mesatares aritmetike (për më shumë detaje, shih Ellis, 2001).

[10] Indeksi i çmimeve të patregtueshme për Shqipërinë është marrë nga Çeliku (2003). Autori llogarit se pesha e të patregtueshmeve (duke përfshirë energjinë dhe lëndën djegëse) në IÇK është 46 për qind.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Vika, Ilir
Kursi real efektiv i këmbimit në shqipëri. Konceptet dhe matja e tij: korrik 2004: Ilir Vika. - Tiranë: Banka e Shqipërisë, 2006

-36 f; 15.3 x 23 cm.
(material diskutimi 18)

Bibliogr.
ISBN 99943-864-1-7
I.Vika, Ilir

336.748(496.5)

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkoni në adresën:

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558
ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 600 kopje